

BULETIN



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

KORRIK – SHTATOR 2005

Buletin 3-mujor /Nr. 13

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbeshtetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. VËZHGIME

- 1.1 Vëzhgimi i procesit të votimit dhe procesit të numërimit
- 1.2 Respektimi i të drejtave të emigrantëve në pikat kufitare të Kapshticës
- 1.3 Respektimi i të drejtave të të paraburgosurve në komisariatit e Korçës

2. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

2.1 Ofrim ekspertize ligjore

- 2.1.1 Ekspertizë ligjore për të drejtat e të miturve – Grupi i punës për konferencën kombëtare të Avokatit të Popullit
- 2.1.2 Ekspertizë ligjore për për legjislacionin financiar - Grupi i punës organizuar nga Fondacioni Soros

2.2 Ngritja e kapaciteteve të administratës së burgjeve

- 2.2.1 Ngritje kapaciteteve ofruar administratës së burgjeve në kuadër të përmirësimit të sistemit të burgjeve

3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

3.1 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase dhe të huaja

- o Takime me përfaqësues të komisariatit të Bilishtit, Kapshticës dhe Korçës
- o Bashkëpunim me vëzhgues të huaj për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005

3.2 Aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit

- o Sesion dëgjimi organizuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës

4. PROJEKTE TË REJA

- 4.1 Projekti rajonal “Raporti rajonal i të drejtave të njeriut”

5. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJVE KORRIK – SHTATOR 2005

5.1 Studime

- 5.1.1 Studim për strategjinë kombëtare të romës për arsimin

5.2 Raporte

- 5.2.1 Raporti Human Rights Defenders

6. TRYEZA DHE KONFERENCA

6.1 Konferencë për shtyp

- 6.1.1 Konferenca për shtyp për përfundimet paraprake për vëzhgimin e procesit zgjedhor

7. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

- a) Ankesat e qytetarëve
- b) Raste të verifikuara

8. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

9. KSHH DHE MEDIA

10. PJES ËMARRJE NË AKTIVITETE TËNDRYSHME

1. VËZHGIME

1.1 Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2006.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit si një organizatë me përvojë në monitorimin e zgjedhjeve parlamentare ndërmori nismën për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, 3 korrik 2005.

KSHH-ja monitoroi me kujdes hapat më të rëndësishëm në përgatitjen e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, ngritjen e administratës zgjedhore, fushatën elektorale, procesin e votimit dhe të numërimit të votave. KSHH-ja aktivizoi vëzhgues **116 vëzhgues vendas** afatgjatë **dhe 7 vëzhgues të huaj afatshkurtër**. Ata u trajnuan për Kodin zgjedhor dhe në mënyrë të veçantë për metodologjinë e vëzhgimit.

Vëzhgimi u shtri në rrethet Tiranë, Durrës, Pogradec, Sarandë, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Kukës si dhe në disa institucione të posaçme, si institucionet e paraburgimit (1), komisariatet në rrethe (7 komisariate), dhe institucionet e vuajtjes së dënimit.

Përfundimet paraprake të vëzhgimit të procesit zgjedhor, KSHH i paraqiti në një konferencë për shtyp, në datën 4 korrik 2005¹.

1.2 Respektimi i të drejtave të emigrantëve në pikat kufitare të Kapshticës

Në datën 19-21 Korrik 2005, KShH realizoi një mision vëzhgimi në pikën e kalim-kufirit të Kapshticës dhe pjesërisht në atë Qafthanës. Qëllimi i këtij misioni ishte ndjekja nga afër i rasteve të keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë të kthyer nga Greqia, trajtimi i rasteve të policisë dhe prokurorisë shqiptare, bashkëpunimi i autoriteteve shqiptare me ato Greke², etj. Gjatë këtij misioni u zhvilluan takime me përfaqësues të Komisarariatit të Bilishtit, komandantin e postës së kalim-kufirit Kapshticë, u monitorua veprimtaria pranë kësaj pike. Gjithashtu u realizuan takime me përfaqësues të organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Korçës dhe u verifikuan procedimet penale³.

1.3 Respektimi i të drejtave të të paraburgosurve në komisaratin e Korçës⁴

Në kuadër të mbështetjes dhe vlerësimit të rrjetit të korrespondentëve dhe mbrojtjes të të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, gjatë muajit korrik 2005 u krye një mision vëzhgimi në komisaratin e Korçës.

Gjatë këtij misioni u morën një sërë takime me shefin e komisarariatit, komandantin dhe përgjegjës të të paraburgosurve të ndodhur në qelitë e këtij komisarati, si dhe me punonjës të tjerë të stafit të këtij komisarati. Gjithashtu u krye një vëzhgim në ambjentet e këtij komisarati si dhe një sërë takimesh me të paraburgosurit e ndodhur aty.

¹ Një raport më të plotë rreth përfundimeve të vëzhgimeve mund të gjeni www.ahc.org.al

² Vëzhgimi u krye në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke” mundësuar financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

³ Më hollësisht këtë informacion do ta gjeni në faqen tonë të internetit www.ahc.org.al

⁴ Vëzhgimi u mundësua financiarisht nga projekti “Së bashku për një shoqëri demokratike ku respektohen të drejtat e njeriut” mbështetur financiarisht nga Fondacioni Soros, në bashkëpunim me projektin “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” nga Komiteti Suedez i Helsinkit

Nga vëzhgimi u vunë re kushtet jo të mira në ambjentet e komisariatit, vonesa në transferimin e personave me vendim të formës së prerë, mungesa e avokatëve në disa raste, mungesa e mjekut në rastet e nevojshme, si dhe probleme të zvarritjeve gjyqësore, etj.

Gjatë këtij misioni vëzhgimi, u vlerësua roli aktiv i korrespondentes të Korçës si nga të dënuarit, të paraburgosurit e institucionit nga vetë administrata e komisariatit, të cilat e kanë ndjerë presionin e vazhdueshëm të KSHH-së për përmirësimin e situatës të të drejtave të njeriut.

2. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

2.1 Ofrim ekspertize ligjore

KSHH nëpërmjet përfaqësuesve të tij ka marrë pjesë në një grup pune të ngritur nga Fondacioni Soros për përmirësimin e legjislacionit financiar për organizatat jofitimpurëse. Në këtë grup pune dhe KSHH-ja ka dhënë kontributin e tij nëpërmjet ekspertizës ligjore financiare. Grupi i punës do të dali me një paketë ligjore të cilën do të propozojë për tu marrë në konsideratë nga organet vendimmarrëse në Shqipëri.

2.2 Ngritja kapacitësh dhe veprimtari trajnuese

2.2.1 Ngritje kapacitësh ofruar administratës së burgjeve në kuadër të përmirësimit të sistemit të burgjeve⁵

Me qëllim mbështetjen e autoriteteve shqiptare në përpjekjet e tyre për ngritjen e kapaciteteve për administratën e institucioneve të vuajtjes së dënimit, KSHH organizoi në datat **10-12 Shtator 2005** një takim vlerësues dhe koordinues me përfaqësues të nivelit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si edhe me përfaqësues të lartë të administratës së burgut të Lezhës. Qëllimi i këtij takimi ishte vlerësimi i rezultateve të punës të arritura me administratën e dy burgjeve pilot përkatësisht të burgut të Rrogozhinës dhe të Peqinit si edhe diskutimi për mundësinë e zbatimit të tyre dhe hartimit të një plani konkret pune me administratën e burgut të Lezhës. KSHH do të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale si edhe në rritjen e shkallës së përgjegjësisë së stafit në trajtimin human të të paraburgosurve dhe të dënuarve sipas këndvështrimit të të drejtave të njeriut.

Në këtë aktivitet, morën pjesë dhe ndihmuan me pjesëmarrjen e tyre Z. Engjëll Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, përfaqësues të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Z. Ded Guri, Drejtor i institucionit të riedukimit Lezhë si edhe përfaqësues të tjerë të administratës së këtij institucioni. Në këtë sesion ofroi ekspertizën e tij Z. Jan van den Brand, ekspert hollandez⁶.

3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

3.1 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase, të huaja dhe organizmat ndërkombëtarë

⁵ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të fazës së dytë të zbatimit të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri- monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe njohja e të drejtave të njeriut dhe ligjeve në këtë fushë” mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁶ Z. Jan van den Brand, drejtor dhe Koordinator i Marrëdhënieve me Jashtë në Agjencinë Kombëtare Hollandeze të institucioneve të Riedukimit si edhe ekspert i Këshillit të Europës për Europën Qendrore dhe Lindore.

3.1.1 Takime me përfaqësues të komisariatit të Bilishtit, Kapshticës dhe Korçës

KSHH gjatë misionit të tij në kufi në Kapshticë, Bilisht ka zhvilluar një sërë takime me përfaqësues të Komisarariatit të Bilishtit, komandantin e postës së kalim-kufirit Kapshticë si dhe u monitorua veprimtaria pranë kësaj pike. Gjithashtu u realizuan takime me përfaqësues të organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Korçës, si dhe me shefin e komisariatit, komandantin, përgjegjësën e të paraburgosurve të ndodhur në qelitë e këtij komisariati, si dhe me punonjës të tjerë të stafit të këtij komisariati.

3.1.2 Bashkëpunim me vëzhgues të huaj për monitorimin e zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005

KSHH gjatë monitorimit të zgjedhjeve parlamentare, korrik 2005 ka patur një bashkëpunim tepër të frytshëm me vëzhgues të huaj norvegjez dhe kosovarë të cilët janë bashkuar vëzhguesve vendas të aktivizuar nga KSHH për të monitoruar procesin zgjedhor në zona të ndryshme zgjedhore.

3.2 Aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit

3.2.1 Sesion dëgjimi organizuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës

Më datë 1 Korrik 2005, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Parlamenti Evropian të angazhuar për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të datës 3 Korrik 2005, organizuan një sesion dëgjimi me anëtarë të ndryshëm të politikës, institucioneve shtetërore dhe vëzhguesit e brendshëm. Në këtë sesion ishte ftuar dhe KSHH-ja ku bëri prezente, rolin e tij në periudhën pas zgjedhjeve Vendore 2003 deri në prag të zgjedhjeve Parlamentare 2005.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të KSHH-së lidhur me aspekte të veçanta të reformës ligjore, shqetësimet e KSHH-së për këtë reformë, listat e votuesve, respektimi i afateve dhe rregullave, ngritja e komisioneve zgjedhore zonale dhe qendrore të votimit, ngritja e komisioneve të numërimit të votave, trajnimi i komisionerëve, etj. KSHH-ja bëri prezente përparësitë dhe mangësitë e shënuara në këtë proces⁷.

4. PROJEKTE TË REJA

4.1 Projekti rajonal “Raporti rajonal i të drejtave të njeriut”

Rrjeti ballkanik i të drejtave të njeriut, anëtarë e të cilës është dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të kontribuojë në përgatitjen e një raporti për të drejtat e njeriut në Ballkan.

Raporti do të jetë burim informacioni dhe konsultimi për qeverinë shqiptare për partnerët tanë dhe mekanizmat ndërkomëtarë të cilët ndjekin nga afër situatën e politike, sociale dhe ekonomike në rajon parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, OJF-të vendase e të huaja.

⁷ Për më shumë shih qëndrimet publike të KSHH-së në faqen e web-it: www.ahc.org.al

5. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJVE KORRIK - SHTATOR 2005

5.1 Studime

5.1.1 Studim për strategjinë kombëtare të romës për arsimin

Ne kuadër të projektit "**Promoting the Rights of Minorities and Enhancing intercommunity Understanding in SEE**" me koordinator rajonal Association for Democratic initiatives, KSHH mori inisiativën dhe realizoi një studim të zbatimit të strategjisë kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetës së minoritetit rom", lidhur me edukimin në rrethet Tiranë dhe Fier.

Korrespondenti i KSHH-së në Fier dhe stafi i KSHH-së në Tiranë kanë realizuar takime me përfaqësues të autoriteteve vendore, përfaqësues të organizatave Rome dhe përfaqësues të vetë komunitetit.

Bazuar në përfundimet e dala, KSHH-ja i adresoi një letër z.Genc Pollo, Ministër i Arsimit dhe i Shkencës.

5.2 Raporte

5.2.1 Raporti Human Rights Defenders

Në kuadër të lobimit të ndërmarrë nga International Federation of Helsinki (IHF), anëtare e së cilës është KSHH-ja, KSHH përgatiti raportin mbi Deklaratën "Human Rights Defenders". Në këtë raport u analizua gjëndja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Ky raport nëpërmjet IHF-së u bë prezente në mbledhjen e radhës së OKB-së në të cilën u përfaqësua edhe shteti Shqiptar.

6. TRYEZA DHE KONFERENCA

6.1 Konferencë për shtyp

Konferenca për shtyp për përfundimet paraprake për vëzhgimin e procesit zgjedhor⁸

Në datën 4 korrik 2005, në ambjentet e Tirana International Hotel, u zhvillua konferenca për shtyp për ku u bënë publike rezultatet paraprake të KSHH-së lidhur me procesin zgjedhor të 3 korrikut 2005. Në këtë konferencë, KSHH paraqiti disa nga përfundimet e vëzhgimit për procesin parazgjedhor, fushatën zgjedhore, procesin e votimit si dhe procesin e numërimit. Kjo konferencë pati një pasqyrim të gjërë nga media e shkruar dhe ajo elektronike.


Një raport i plotë do të botohet në faqen e internetit të KSHH-së⁹.

7. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

Pavarsisht nga periudha e pushimeve, letrat e qytetarëve, kanë qënë pothuajse në të njëjtat nivele. Gjatë periudhës Korrik-Gusht 2005 në adresë të KSHH-së kanë ardhur gjithsej 50 letra dhe telefonata të cilat kanë patur objekte të ndryshme ankesash, të cilat i nëpërmjet paraqitjes grafike.

⁸ Konferenca për shtyp dhe raporti përfundimtar i zgjedhjeve do të mbulohet financiarisht nga CORDAID

⁹ Raportin për përfundimet paraprake për vëzhgimin e zgjedhjeve mund ta gjeni bashkangjitur në aneksin Nr. 1 të këtij raporti



Vihet re një rritje e numrit të kërkesave të personave të dënuar për të ndërhyrë pranë autoriteteve të burgjeve lidhur me përmbushjen e të drejtës së tyre për transferim, mbi kushtet në burgje, ushtrim dhune, mospasja e kushteve për ushtrimin e riteve fetare, etj. Mund të themi se gjatë kësaj periudhe është rritur edhe numri i ankesave të ardhura nga personat të cilët pretendojnë se kanë probleme shëndetësore, por që nuk iu është dhënë asistencë e duhur mjekësore.

KSHH nëpërmjet shërbimit ligjor që ka bërë, ka sqaruar ankuesit për shumë probleme dhe çështje ligjore si dhe u ka kërkuar autoriteteve shtetërore të ndërhyjë për të zgjidhur çështjet.

Në trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e tyre vlen të përmendet bashkëpunimi i mirë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila ka shprehur gatishmërinë për verifikimin e ankesave, dhe marrjen e masave të duhura ligjore.

Raste të verifikuara

- Në datën **15 Korrik 2005**, në bazë të ankesave të disa të dënuarve të institucionit të Veçantë Krujë të ardhura në adresë të KSHH-së, u realizua një mision sporadik vëzhgimi në këtë institucion. Objekti i misionit të vëzhgimit ishin disa pretendime të disa të dënuarve lidhur me ndalimin e korrespondencës së tyre nga ana e institucionit të riedukimit, subjektivizmi në realizimin e transferimeve të të dënuarve nga një burg në një tjetër si edhe lidhur me vendosjen e rrjetave të hekurit në dritaret e dhomave të të dënuarve e cila pengonte shumë hyrjen e dritës dhe të ajrit në to. Përfaqësues të KSHH-së morën takime me përfaqësues të lartë të administratës së këtij burgu si edhe me të dënuarit që ishin ankuar. Në bazë të konstatimeve të rezultuara nga ky vëzhgim, KSHH informoi Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për verifikimin e pretendimeve të ngritura si edhe për marrjen e masave konkrete në rast nevojë.
- Në datën **29 Shtator 2005**, KSHH pas një sinjalizimi që pati nga media e shkruar u vu në dijeni të një rasti ku pretendohet për kushte çnjerëzore dhe shumë të këqija të dhomave të paraburgimit të komisariatit të Mirditës. Në këtë artikull pretendohet se të paraburgosurit përpara se të vendoseshin në burgun e Lezhës kalonin disa ditë në kushte çnjerëzore në dhomat e paraburgimit të këtij komisariati. Për këtë qëllim, KSHH ndërmori një misioni vëzhgimi për të verifikuar nga afër gjendjen e dhomave të paraburgimit të këtij komisariati. Nga verifikimi i kryer si dhe nga takimet që përfaqësues të KSHH-së morën me drejtuesit e

komisariatit të Mirditës rezultoi se të dhënat e artikullit të mësipërm nuk ishin të vërteta pasi të paraburgosurit nuk qëndronin në këto dhoma paraburgimi, por ata transferoheshin brenda 48 orëve në burgun e Lezhës.

- Gjatë muajit shtator 2005, në adresën e KSHH-së ka ardhur një ankesë nga një emigrant në Islandë, Gj.S, i cili ankohej për shkeljen e të drejtave të tij procedurale në shtetin e Islandës si dhe mosdhënien e statusit të emigrantit. KSHH këtë ankesë iua ka bëri të ditur dhe organizatave si IOM dhe UNHCR, për ta përcjellë këtë ankesë tek autoritetet irlandeze¹⁰.

8. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

KSHH gjatë kësaj periudhe ka komunikuar vazhdimisht me institucionet shtetërore dhe organizatat vendase dhe të huaja. Korrespondenca ka konsistuar kryesisht në zgjidhjen e ankesave të ardhura në adresë të KSHH-së, si edhe në informimin e tyre rreth problemeve të dala.

Përgjithësisht, letrat e ardhura nga institucionet shtetërore, kanë qenë në përgjigje të letrave të KSHH-së. Vlen të përmendet korrektesa në verifikimin e ankesave që KSHH-ja u përcjell këtyre institucioneve dhe përgjigja e dhënë prej tyre. Në korrespondencën e hyrë nuk kanë munguar edhe ftesat për pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga këto institucione.

9. KSHH DHE MEDIA

KSHH gjatë kësaj periudhe ka shkruar një sërë shkrimesh dhe opionesh kryesisht për procesin zgjedhor. Gjithashtu stafi drejtues i KSHH-së ka dhënë një sërë intervistash kryesisht për rezultatet e vëzhgimit të procesit zgjedhor, si dhe për probleme të ndryshme shqetësuese lidhur me të drejtat e njeriut.

10. PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË NDRYSHME

- Ne datën 5 Korrik 2005 Qendra për Nisma Ligjore Qytetare organizoi një tryezë të rrumbullakët në të cilën u diskutua projektligji mbi Dhunën në Familje si edhe u paraqit një studim i kryer nga kjo qendër mbi rastet e dhunës në familje. Në këtë takim u diskutua mbi projektligjin "Mbi dhunën në familje". Në këtë takim mori pjesë E.Sefa, juriste/As.Projektsh në KSHH.
- Në datën 27-28 Shtator 2005 u organizua takimi vijues për vlerësimin e zbatimit të Konventës Kuadër "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare", organizuar nga Komiteti Këshillimor i Këshillit të Europës. Në të u paraqitën opinione të ndryshme mbi gjendjen e pakicave në Shqipëri, pjesëmarrjen e pakicave në jetën publike dhe socio-ekonomike, përdorimi i gjuhës së pakicave dhe edukimi i tyre në gjuhën amtare, si edhe u diskutua mbi Strategjinë kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome". Në këtë takim morën pjesë, znj.V.Hysi, Drejtore Ekzekutive e KSHH-së, E.Papavangjeli, Koordinatorë programesh në KSHH, dhe znj. K.Alikaj, juriste/As.administrative në KSHH
- Në datën 18 korrik 2005, Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë në datën 18 Korrik 2005 në ambjentet e Muzeut Historik Kombëtar zhvilloi analizën e 6 mujorit të parë të vitit 2005 mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Në këtë takim mori pjesë E.Sefa, juriste/As.Projektsh në KSHH.
- Në datën 28 Korrik 2005, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar prezantoi raportin e vëzhgimit të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar

¹⁰ KSHH-ja përfiton nga rasti të falenderojë Organizatën Ndërkombëtare për Emigrim, për gatishmërinë e treguar në zgjidhjen e kësaj çështje dhe shpreson se ndihma do të jetë efektive.

- në procesin zgjedhor të datës 3 Korrik 2005. Në këtë takim mori pjesë E.Sefa, juriste/As.Projektsh në KSHH
- Në datën 22 Shtator 2005, UNHCR në bashkëpunim me IOM dhe OSBE organizuan një ëorkshop lidhur me rolin dhe ndikimin e organizatave jofitimprurëse dhe medias në fushën e azilit dhe migrimit. Në këtë takim mori pjesë E.Sefa, juriste/As.Projektsh në KSHH
 - Në datën 19 – 23 shtator 2005, OSCE/ODIHR organizoi në Varshavë, takimin e përvitshëm për zbatimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut gjatë vitit 2005. Në këtë takim u diskutuan çështje si zgjedhjet demokratike, demokracia në nivelet rajonale, lokale dhe kombëtare, qytetarët dhe të drejtat e tyre politike, migrimi, refugjatët, punësimi i emigrantëve, liria e lëvizjes, liria e mbledhjes, liria e shprehjes dhe e informacionit, metodat e ndalimit dhe luftës kundër torturës, transparenca legjislative, etj. Në këtë takim të rëndësishëm mori pjesë dhe KSHH me përfaqësuesen znj. E.Papavangjeli, Koordinatorë programesh në KSHH¹¹.
 - Në datën 21 shtator 2005, Qendra e sutedimeve parlamentare organizoi tryezën për prezantimin e rezultateve të monitorimit mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare. Në këtë takim mori pjesë z.N.Jaho, Këshilltar ligjor i KSHH-së.
 - Në datën 28 shtator 2005, NDI në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së shtetit organizuan konferencën e IV kombëtare, “Besim publik – sfidë për policinë”. Në këtë konferencë mori pjesë E.Saliu, juriste/Koordinatorë projekti në KSHH.
 - Në datat 29-30 Shtator 2005, në Beograd, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Beograd e cila koordinon këtë projekt rajonal, ftoi përfaqësuesit e disa organizatave zbatuese të projektit “Raporti rajonal i të drejtave të njeriut”, në një mbledhje pune. Kjo mbledhje shënoi fillimin e këtij projekti rajonal¹². Në këtë mbledhje KSHH u përfaqësua nga Znj. E. Papavangjeli, Koordinatorë e Programeve në KSHH.

Përgatiti për Internet: ***Etilda SALIU***

Juriste/As.projektesh

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në adresën:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1, Ap.4, Tiranë, Kutia postare Nr. 1752

Tel: 04 233671 & 04 229002

Fax: 04 233 671

E-mail: office@ahc.org.al; web site: www.ahc.org.al

¹¹ Shih Aneks për ndërhyrjet e KSHH-së në këtë takim ndërkombëtar në dy fusha të rëndësishme ku ajo operon

¹² Për më shumë shih piken 4 të këtij buletini, “Projekte të reja”

ANEKS NR.1 - DEKLARATA

1. RAPORT PARAPRAK PËR ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE 3 KORRIK 2005 NË SHQIPËRI

Tiranë, më 4 Korrik 2005

Hyrje

1 Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është organizata e parë joqeveritare e krijuar në Shqipëri në dhjetor të vitit 1990. Misioni i saj është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të shtetasve. KSHH-ja ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore që janë zhvilluar në Shqipëri.

2 KSHH-ja vlerësoi rëndësinë e këtyre zgjedhjeve dhe ndoqi me kujdes hapat më të rëndësishëm në përgatitjen e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor dhe ngritjes së administratës zgjedhore, fushatën elektorale dhe procesin e votimit dhe po vazhdon të ndjekë procesin e numërimit të votave.

3 Për zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005, KSHH-ja aktivizoi vëzhgues afatgjatë të akredituar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ-së), **nga të cilët u aktivizuan 116 vëzhgues vendas dhe 7 vëzhgues të huaj.**

4 Vëzhguesit e KSHH-së monitoruan ecurinë e fushatës zgjedhore në disa rrethe¹³, faktin nëse anëtarët e Komisioneve Zonale të Zgjedhjeve (KZZ) trajnoheshin, ngritjen dhe trajnimin e anëtarëve të qendrave të votimit, ushtrimin e së drejtës së regjistrimit me vendim gjykatë të zgjedhësve të mbetur jashtë listës përfundimtare të votimit, marrja e materialeve zgjedhore që KQZ-ja duhej t'i dërgonte KZZ-ve.

5 KSHH-ja monitoroi rreth 1000 qendra votimi në rrethe kryesore të vendit, ndër të cilat u përfshinë edhe disa burgje dhe vende paraburgimi. Gjithashtu, KSHH-ja po monitoron 25 qendra të numërimit të votave në KZZ-të ku u shtri vëzhgimi.

Falenderime¹⁴

6 KSHH-ja falenderon të gjithë vëzhguesit afatgjatë të tij për profesionalizmin, paanshmërinë, përkushtimin, komunikimin me etikë të vërejtjeve në qendrat e votimit.

7 KSHH-ja dëshiron të falenderojë KQZ-në për akreditimin e shpejtë të vëzhguesve të KSHH-së dhe për informimin dhe vënien në dispozicion të udhëzimeve dhe informacioneve të nevojshëm për vëzhgim.

8 Ky raport paraqet disa përfundime paraprake lidhur me aspekte të veçanta të procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 në zonat zgjedhore ku është shtrirë vëzhgimi i KSHH-së.

Kuadri ligjor

¹³ Qëndrat e votimit të vëzhguara janë përfshirë në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë (pjesërisht), Kukës, Vlorë, Pogradec. Qëndrat e votimit në burgjet Lezhë, Vaqar, Peqin, Rrogozhinë, dhe 325 Tiranë dhe në institucionet e paraburgimit 313 dhe 302 Tiranë, Lezhë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Vlorë.

¹⁴ KSHH-ja përfiton nga rasti të falenderojë Fondacionin e Shoqërisë së Hapur (SOROS), Komitetin Suedez të Helsinkit dhe CORDAID për mundësinë që i krijuan organizatës për të mbështetur kryerjen e vëzhgimeve të zgjedhjeve parlamentare të 3 korrik 2005.

9 Zgjedhjet parlamentare të 3 korrik 2005 u zhvilluan në bazë të kodit të ri të ndryshuar dhe të miratuar në janar 2005. Kuvendi ngriti komisionin bipartisan për reformën zgjedhore. Si ngritja edhe puna e tij ishin të vonuara. Dy ishin problemet që shkaktuan vonesa të theksuara: a) Përbërja e KQZ-së dhe b) Ndarja e zonave elektorale. E para u zgjidh me konsensus duke vendosur mbarimin e parakohshëm të mandatit të një anëtarit të KQZ-së dhe zëvendësimin e tij me një kandidat të propozuar nga opozita, ndërsa çështja e tjetër u shty për t'u zgjidhur më vonë.

10 **Jo vetëm ndryshimet e Kodit Zgjedhor u bënë me vonesë, por edhe ligji për ndarjen e zonave u miratua në fillim të Marsit 2005, gjë që deri në një farë mënyrë ndikoi edhe në ngritjen me vonesë të KZZ-ve.** Gjithashtu, vonesa u vunë re në përgatitjen e listave paraprake, shpalljen e tyre, rregjistrimin e subjekteve zgjedhore. Këto procese u shoqëruan shpesh me debate të ashpra politike.

Administrata zgjedhore

11 KSHH-ja ka ndjekur me vemëndje veprimtarinë e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së) dhe konstaton se ajo u karakterizua nga profesionalizimi, objektiviteti dhe transparenca, paanshmëria dhe operativiteti. Shkelja e disa afateve ligjore ka qenë pasojë e faktit se disa nga partitë politike nuk kanë zbatuar kërkesat lidhur me afatet për propozimet e anëtarëve të KZZ-ve dhe KQV-ve. Edhe gjatë procesit të votimit, KQZ-ja demonstroi profesionalizëm dhe vullnet për të administruar procesin e votimit sipas standarteve të kërkuara.

12 Komisionet e zonave zgjedhore (KZZ-të) për zgjedhjet parlamentare 2005, siç u përmend u ngritën me vonesë. Sipas ligjit, afati i fundit i tyre ishte më 3 mars 2005, ndërkohë që gjashtë partitë përkatëse politike që kishin të drejtë të bënin propozime e ushtruan këtë të drejtë me vonesë. Si pasojë edhe trajnimi i tyre u bë me vonesë.

Trajnimi i komisionerëve

13 Disa të meta dhe shkelje të dispozitave ligjore të vëna re në qendrat e votimit të vëzhguara nga aktivistët e KSHH-së, **kanë të bëjnë me trajnimin jo-cilësor dhe jo të mjaftueshëm të anëtarëve të KZZ-ve për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga partitë politike përkatëse dhe ngritjes së tyre me vonesë.** Për të njëjtin shkak, me vonesë u ngritën edhe KQV-të (në shkallë vendi afërsisht 40000 anëtarë). Kjo vonesë pati ndikim në zgjedhjen e problemeve që lindën gjatë ditës së votimit.

Regjistrimi i partive jo -parlamentare dhe kandidatëve

14 Për zgjedhjet parlamentare 2005 janë rregjistruar 27 subjekte zgjedhore, 1230 kandidatë për deputetë. Sipas ligjit, partitë e rregjistruara si subjekte zgjedhore ishin të detyruara të paraqesnin një listë kandidatësh për 40 vende në Kuvend dhe se lista duhet të mbështetej nga 7000 firma të votuesve. Nga verifikimet e bëra nga KQZ-ja rezultoi se disa firma ishin të falsifikuara. KSHH-ja me anë të një deklaratë publike i kërkoi KQZ-së të bëjë verifikimet e nevojshme.

Në këto zgjedhje u vu re se kandidatë të një forcë politike u regjistruan nën siglën e një partie tjetër. Edhe në spotet dhe materialet informuese të këtyre forcave, të shpërndara ose të bëra publike në mjedise të ndryshme, u vu re ky fenomen.

Listat e zgjedhësve

15 Sipas Kodit zgjedhor (neni 64/2 pika 2) listat paraprake duhej të shpalleshin jo më vonë se data 31 mars 2005. Në rrethet e vëzhguara nga KSHH, **listat paraprake u shpallën në disa ditë vonesë.** Pas shpalljes së listës paraprake, kryetarët e njëzive vendore duhet të bënin njoftimin me shkrim të zgjedhësve. Nga ana tjetër, u vu re një indiferentizëm nga ana e zgjedhësve për të kontrolluar në kohë nëse emrat e tyre ishin në listë dhe për të kërkuar ndryshimet e mundshme në rast mungese të emrit të tyre në listën përfundimtare.

16 Në këto zgjedhje u bë një punë më e mirë për hartimin e listave të zgjedhësve megjithësi përsëri u vërtetuan mungesa dhe pasaktësi. Një pjesë e listave u korrigjuan pas shpalljes së listave paraprake, ndërsa një pjesë tjetër nëpërmjet vendimeve gjyqësore të cilat mund të jepeshin jo më vonë se 6 orë para mbylljes së votimit.

Fushata zgjedhore

17 Në fillimet e saj fryma e fushatës zgjedhore ishte relativisht e qetë. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara, pozitiv ishte zhvillimi i debateve televizive dhe shpalosja e programeve dhe alternativave të çdo subjekti zgjedhor. Megjithë fillimet e mbara, fushata zgjedhore, sidomos në prag të afrimit të ditës së votimit u ashpërsua dhe u shoqërua me akuza të ndërsjella. U vunë re shkelje të kodit të etikës nga subjekte zgjedhore dhe kandidatët e tyre. Pati raste ku u shënuan incidente në formën e grisjes së posterave, grindjeve dhe rrahjeve ndërmjet shtabeve të kandidatëve.

18 Gjatë kësaj fushate ranë në sy shpenzimet e mëdha të subjekteve zgjedhore gjatë fushatës elektorale, sidomos të atyre të partive të mëdha. KSHH-ja inkurajon zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me verifikimin e burimeve financiare të fushatës.

Media gjatë fushatës dhe procesit të votimit

19 Në përgjithësi media mbuloi fushatën. Sensibilizimi i publikut ishte i mirë. Në disa raste, spotet televizive të partive ishin të ashpra dhe cënonin etikën. Gjatë ditës së votimit, media bëri një mbulim të plotë të ecures së këtij procesi. U konstatuan raste të cënimit të heshtjes zgjedhore nga subjektet gjatë deklarimeve publike për median.

Situata e përgjithshme e zhvillimit të zgjedhjeve

20 Zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 u zhvilluan në një situatë përgjithësisht të qetë, megjithëse u verifikuan disa incidente në zona të caktuara. KSHH-ja vlerëson maksimalisht pjesëmarrjen masive të zgjedhësve shqiptarë në këto votime, qytetarinë dhe përgjegjshmërinë e tyre në këtë proces.

21 Edhe në këto zgjedhje, partitë politike megjithë pranimin e kodit etik e cënuan atë qoftë gjatë fushatës elektorale edhe gjatë ditës së votimit. Kishte komisionerë që nuk treguan përgjegjshmëri dhe vullnet politik gjatë ditës së votimit ç'ka solli moszhvillimin e zgjedhjeve në disa qendra votimi.

Policia e shtetit

22 Nga vëzhgimet e KSHH-së rezultoi se punonjësit e policisë së shtetit kanë kryer me korrektësi detyrat e ngarkuara nga Kodi Zgjedhor dhe udhëzimi përkatës i KQZ-së, ndërkohë policia ka garantuar edhe rendin e zhvillimit normal të të gjitha tubimeve të organizuara nga subjektet zgjedhore.

Ngritja e qendrave të votimit

23 KSHH-ja konstatoi se vendodhja e disa qendrave të votimit ndryshoi në momentet e fundit dhe se në disa komisarate policie si në atë të Elbasanit, Gjirokastrës dhe Kukësit nuk u ngritën qendrat e votimit. Disa qendra votimi të vëzhguara ishin vendosur në lokale të papërshtatshme, cilat kufizonin lëvizjen e votuesve dhe qëndrimin e vëzhguesve. Veç kësaj, kishte qendra votimi me nbi 1000 -1800 zgjedhës, kur sipas ligjit nuk duhet të kishte më shumë se 1000 zgjedhës.

Procedurat e hapjes së votimit dhe votimi

24 Në pjesën më të madhe të qendrave të vëzhguara nga KSHH-ja, ato janë hapur në kohë ose me vonesa jo shumë të theksuara. Në përgjithësi, komisionerët e QV-ve respektuan kërkesat e kodit zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së lidhur me hapjen e qendrave të votimit. KQZ-ja dërgoi në kohë materialet

zgjedhore, por në disa raste u vunë re vonesa në tërheqjen e tyre. Në shumicën e qendrave të vëzhguara numri i fletëve të votimit përkonte me numrin e zgjedhësve.

25 Në përgjithësi, **procedura e votimit filloi në kohë**, por në disa qendra pati vonesa të vogla si pasojë e ardhjes me vonesë të komisionerëve, mosardhjes së kutisë së votimit, mungesës listës me emrat e votuesve, etj.

Në përgjithësi, **komisionet e QV-ve respektuan rregullat e votimit**, sidomos në pjesën e parë të ditës, por kjo gjë nuk mund të thuhet për orët e fundit të votimit, ku në disa QV u vu re një fluks në rritje të votuesve, ç'ka sollim zgjatjen e procesit të votimit.

26 Një ndër problemet e konstatuara në këto zgjedhje ishte **përdorimi i certifikatave të parregullta**. KQZ-ja urdhëroi mbajtjen e të gjithë certifikatave pas votimit dhe kërkoi që votuesit që do të përdornin certifikata me fotografi si mjet identifikimi, duhej të ishin pajisur me dokumenta identifikimi shtesë për të minimizuar përdorimin e certifikatave të parregullta. Megjithatë, në disa QV, komisionerët nuk e zbatuan këtë udhëzim për të gjithë votuesit, madje kishte raste që komisionerët kanë pranuar të votojnë me certifikata të vjetra, ndërkohë që disa raste votuesit e rregjistruar me vendim gjyqësor e humbën këtë për shkak të mungesës së certifikatave. Pra, **komisionerët e qendrave të votimit nuk mbajtën qëndrime të unifikuara në këtë drejtim**. Sipas KSHH-së, qëndrimet e ndryshme të KQV-ve erdhën si rrjedhojë e mosnjohjes së udhëzimeve të KQZ-së ose mungesës së vullnetit politik për t'i zbatuar ato.

27 Në shumë qendra të vëzhguara u vu re **votimi famijar si dhe mungesa e lehtësive për votuesit me aftësi fizike të kufizuara dhe të moshuarit**. Vëzhguesit e KSHH-së vunë re se megjithesë kodi zgjedhor parashikon gjithë mundësitë për ushtrimin e së drejtës së votës, vullenti i tyre u cënua. U vunë re raste që këta persona nuk u lejuan të votonin ose kur e ushtruan të drejtën e votës ata u ndihmuan nga një anëtar i komisionit ose një votues ndihmoi më shumë se një person.

28 Në disa qendra votimi ka patur **pezullime të përkohshme të procesit të votimit** për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet komisionerëve, tërheqjes me vonesë të materialeve ose pranisë së materialeve propogandistike brenda kufijve të ndaluar nga ligji.

29 Në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit të vëzhguara, **dhoma e fshehtë ishte vendosur në një pozicion të tillë që mund të cënonte fshehtësinë e votës**. Pas vërejtjeve të vëzhguesve, në disa qendra, komisionet reagon duke marrë masat përkatëse.

30 Në disa qendra votimi **ka pasur raste kur ndaj votuesve është ushtruar presion nga simpatizantë të subjekteve zgjedhore ose komisionerë**.

Procedurat e mbylljes së votimit

31 Për shkak të fluksit të madh të votuesve që prisnin të votonin në prag të mbylljes të qendrave të votimit, në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit porcesi i votimit u zgjat tej afatit ligjor. Për pasojë, procedura e mbylljes së votimit, administrimi i materialeve zgjedhore, dërgimi i kutive të votimit në KZZ dhe fillimi i numërimit të votave u shty në kohë.

Procedurat e numërimit të votave

32 KSHH-ja po vëzhgon procesin e numërimit të votave i cili është në vazhdim. Në raportin përfundimtar KSHH-së do të ketë vlerësime të detajuara dhe rekomandime përkatëse për çdo aspekt të procesit zgjedhor, të vëzhguara prej tij

Përfundime

33. Në përfundim, Komiteti Shqiptar i Helsinkit përshëndet në mënyrë të veçantë interesimin e zgjedhësve shqiptarë për të qënë pjesë e fushatës dhe procesit zgjedhor. Duke marrë pjesë në mënyrë

masive në këto votime kaq të rëndësishme, shqiptarët treguan pjekurinë dhe përgjegjshmërinë e tyre qytetare në përmbushje të standartave që kërkohen për të patur zgjedhje të lira, të ndershme dhe të demokratike.

2. ELECTIONS RELATED ISSUES IN ALBANIA

In Albania, the July/August 2005 parliamentary elections reflected improvements over the past local government elections and parliamentary elections in some areas. This is according to AHC's monitoring carried out in a considerable number of voting and counting centers in some districts of the country as well as the monitoring of the pre-electoral process. However, serious shortcomings remained during the whole process which led to failure of meeting all OSCE commitments and international standards.

Some positive areas to be highlighted are: the satisfactory participation of the Albanian voters in these elections demonstrating this way their responsibility and civilization in this process; the positive role of the police forces which performed their duties as required by law during the electoral process; and the involvement of a considerable part of national observers monitoring the elections reflected an increased role of the civil society in the country.

Nevertheless, there were still many shortcomings observed. Although voters' lists were much improved, still they had problems; in some Voting Centers' and Zone Counting Centers commission members were insufficiently trained which resulted to deficiencies, lack of professionalism, impartiality and sometimes politicization from their part while performing their duties as defined by law. There were also irregularities regarding identification documents such as birth certificates, family voting, in some cases disabled persons were not facilitated in exerting their right to vote, the effect of "Mega-Dushk" strategies in infringement of the will of the voters which comes in contradiction with article 64 of the Constitution of the Republic of Albania; the misuse of all the legal provisions to protract the announcement of the official results of the elections in Albania.

Despite of the improvements observed during these elections and despite of the fact that Albanian voters were free to exert their right to vote, there have been exchange of mutual accusations from both political wings stating that elections were not fair, which remains disturbing.

Recommendations

During the up-coming elections for local government organs, the government of Albania should submit amendments to the election code to remedy the existing problems. National experts in the field should be involved in the process of further improvement of the electoral reforms, based on the recommendations provided by OSCE/ODIHR. Among them should be taking appropriate safeguards in order not to misuse the electoral system, be this mixed electoral system or only a proportional one. Special attention should be paid to the training of the commissioners and to the further improvement of the voters' list.

Warsaw, on 19 September 2005

3. Issues related to the treatment of citizens in closed institutions in Albania

AHC is currently carrying out a project "Prison Reforms and Civil Society in Albania - Monitoring the Respect of Human Rights in Prisons and Pre-Detention Sites in Albania, and Enhancing Awareness and Recognition of Human Rights and Rule of Law in this Area¹⁵". In the course of this project several planned proactive and reactive monitoring missions are undertaken in all prisons and in almost the majority of the pre-trial detention centers all over Albania.

¹⁵ This project is financially supported by the Swedish Helsinki Committee.

During year 2004-2005 there were some positive developments in regard with legislative reforms in the juvenile justice system, measures taken to enforce the law regarding the transfer of all persons with final form decision from the pre-detention sites to prisons, review of different laws and by-laws in this area, institutional positive developments such as an agreement between the Ministry of Justice and the Ministry of Health regarding opening an institution for health mentally disturbed convicts as well as infrastructural measures for the improvement of physical conditions in prisons. Furthermore, opening of a high security section in Peqin prison, of Lezha pre-detention and prison with a highest capacity of 850 and the transformation of prison 302 into pre-detention facility under the General Directorate of Prisons reduced the overcrowding especially in police commissariats.

Despite the improvement in the pre-detention sites and prison system, there are still problems. Keeping a considerable part of the pre-detention facilities under the competence of the Ministry of Public Order is contrary to the law. The overcrowding phenomenon especially in prisons at present, the transferring of convicted persons with the final decisions from pre-trial detention centers to prisons which still require a better coordination of all the relevant competent state bodies, poor hygiene and poor quality of food provided to persons deprived of their liberty, and irregular medical control made the living of these categories of citizens very difficult. Insufficiencies with medicaments to both prisoners and pre-trial detainees, insufficient care for juveniles and women especially with psycho-social programs designed for them which are generally lacking, are still problems that the penitentiary system is facing at present. Lack of or limited knowledge of convicts about the rights ensured by law and the fact that Albania still is not able to start the alternative to punishment and criminal policy is focused only in the imprisonment contribute to overcrowding situations in the prisons. There are legal and practical obstacles that have made it impossible for the responsible state authorities in closed institutions to ensure work for prisoners.

There are positive measures taken from the part of the Ministry of Justice and especially of the GDP to improve the mechanism of requests and complaints from prisoners within the prison system. In addition to these internal mechanisms there exist external mechanisms to hear requests and complaints from persons deprived of their liberty such as People's Advocate or actors of civil society, but still there are steps and measures to be taken to make this mechanism especially that within the state structures more functional. The same holds true for the controlling mechanism which should be in place in regard with the disciplinary sanctions rendered by prison governors towards prisoners.

The above shortcomings, deficiencies, and violations of the law that infringe the rights of prisoners and have a negative effect on their treatment remain disturbing. Some are of an objective character, but others are of a subjective character. The former deal with the relatively poor condition of infrastructure, whereas the latter have to do with deficiencies in the rigorous enforcement of the law, as well as with unjust concepts that exist among part of prison personnel regarding convicts.

Recommendations

- 1. Transference of the whole system of pre-trial detention centers under the supervision of the Ministry of Justice should take place as soon as possible.*
- 2. Measures should be taken to ensure a psycho-social treatment of juveniles in particular and prisoners in general;*
- 3. Immediate measures should be taken to make possible the provision of work and/or vocational training to prisoners in prisons.*
- 4. Training and increasing the capacities of the prison administration remains still a priority which will guarantee the strict implementation of domestic and international standards in this area and would provide a humane treatment of persons deprived of their liberty.*

Warsaw, on 19 September 2005